

“Vlerësimi Teknik dhe Siguria e Digave të Bujqësisë në Shqipëri” dhe Modelet e Organizimit




Kuadri Ligjor për


PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DIGAVE DHE DAMBAVE

- **L I G J Nr. 8681, datë 2.11.2000 “PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, SHFRYTËZIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E DIGAVE DHE DAMBAVE”**
- **V KM Nr.278, datë 8.5.2003 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT TË KOMITETIT KOMBËTAR TË DIGAVE TË MËDHA (KKDM) DHE TË KËSHILLIT TEKNIK TË PËRHERSHËM TË DIGAVE (KTPD)”**
- **UDHËZIM Nr.4, datë 18.7.2003 “PËR KËRKESAT E DOKUMENTACIONIT LIGJOR DHE TEKNIK, QË DUHET TË PËRMBAJË DOSJA E DIGAVE DHE E DAMBAVE”**
- **VKM Nr.147, datë 18.3.2004 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR SIGURINË E DIGAVE DHE TË DAMBAVE”**
- **V KM Nr.1108, datë 30.12.2015 “PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT”**

HISTORIKU I DIGAVE TË BUJQËSISË


- Bazuar në inventarin e Ministrisë së Bujqësisë në vend janë ndërtuar rreth 680 diga për qëllime bujqësore me kapacitet ujqor rreth 500 milion m³ ujë me aftësi ujitëse 180,000 ha.
- Ndërtimi i digave në vendin tonë është i hershëm. Diga e parë e dokumentuar është ajo e Krapsit, e ndërtuar me gurë në shekullin e dytë të erës sonë ne luginën e Gjanicës.
- Digat për qëllime bujqësore kanë fillimet në fillimet e viteve 60 me ndërtimin e digave të rezervuarëve Kurjan 1954, Diga e Liqenit të Tiranës 1959, Diga e Thanës 1962, Tarin 1963 etj.
- Digat e bujqësisë në vendin tonë ndahen kryesisht:
 - në vepra nivel ngritëse si: me spica si në Osum, me porta metalike si: Vlashuku e Zemblaku në Devoll, Cengelaj në Shkumbin, Skorana dhe Ndroq në Erzen, Spathara në Vaun e Dejës.
 - Në diga me material vendi: homogjene apo me bërthamë argjile

- 
- Në bazë të V KM Nr.1108, datë 30.12.2015 “PËR TRANSFERIMIN, NGA MINISTERIA E BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE TE BASHKITË, TË INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT, TË PERSONELIT DHE TË ASETEVE TË LUAJTSHME E TË PALUAJTSHME TË BORDEVE RAJONALE TË KULLIMIT” Ministria e Bujqësisë është përgjegjëse për administrimin e 7 digave, ndërsa Njësitë e Pushtetit Vendor/Bashkitë janë përgjegjëse për administrimin e gjithë pjesës së mbetur .
 - Digat në administrimin e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave janë:
 - Diga Shtodër (Shkodër), Bllacë (Bulqizë), Belesova (Berat), Thana (Lushnjë), Gjanc (Korcë), Doftia (Gjirokastër) dhe Janjar (Konispol).



Nga një studim i kryer nga Ministria e Bujqësisë dhe Bankës Botërore për “Vlerësimin Teknik dhe sigurisë së digave bujqësore” të vitit 2009 u morrën në studim 196 diga, pra afërsisht 30% e numrit të përgjithshëm të digave. Disa nga gjetjet e këtij studimi janë:

- 70 (36%) e digave kanë probleme gjeoteknike, ku përfshihen rrëshqitje të vjetra apo të reja, gropa sufozie, ulje të konsiderueshme, carje, ose lëvizje të konsiderueshme. Shumë nga digat kanë rrudhosje të skarpatave që paralajmërojnë ngjeshje jo të mira ose fillimet e ndonjë rrëshqitjeje. Në këtë grup mund të përmenden digat e Koshnicës 1 & 2, Xhafzotaj, Bajkaj, T’Plan, Sharrëdushk, Zall Herr 2 dhe shumë të tjera.
- 45 (23%) e digave nuk kanë sot shkarkues në kushte normale si dhe shumë shkarkues kanë bllokime me dhera e materiale të ndryshme.
- Vetëm 46 nga diga kanë shkarkues, të cilët e përballojnë prurjen llogaritëse dhe kanë një franko të mjaftueshme për të përballuar lartësinë e valëve sipas standarteve ndërkombëtare të ICOLD.
- 16 (8%) e digave kanë ujëleshues të dëmtuar në trupin e digës dhe 8 nga ato kanë shenja që tubi duket me sy i dëmtuar. Në këtë grup hyjnë digat T’Plan, Shishtufinë, etj.

- 
- 62 (32%) e digave paraqesin shenja të filtrimeve në skarpatë. Në këtë grup hyjnë digat Dardhë 2, Shishtavec etj.
 - 120 (62%) nga digat kanë rrugë shërbimi në gjendje shumë të keqe. Ky fakt do të ndikojë në të ardhmen në mirëmbajtjen e sidomos për hyrjen në rastet e ndonjë emergjence. Në disa diga gjurma e rrugës automobilistike është zhdukur me kilometra të tërë. Të tilla janë Dardha 1 & 2, Varavara 1 & 2, Protopapa 1, Gjergjevica, etj.
 - 6 (3%) e digave janë gjetur të shkatërruara aq sa nuk arrijnë të mbajnë aspak ujë ose shumë pak. Këto janë Varvara 2 & 3, Kodra Pilafit, Peshtan, Gjonomadh dhe Protopapa 1.
 - 9 (3%) e digave janë gjetur me mbushje të konsiderueshme të kupës së rezervuarit me material të ngurtë. Këtu përmendim Duhanas, Belesova, Zharrës, Peze Gjyslylkonja, Skorana, Patku 1, Gopesh, Zambishti, dhe Puka.
 - 5 (2%) e digave janë gjetur pothuaj të thata sepse rezervuari është ndërtuar në zona karstike gëlqerore. Këtu përmenden Rrapsh Starja, Kalivaci, Mollas, Qerret dhe Bratila.
 - 3 (1%) e digave janë gjetur të papërfunduara sipas projektit fillestar. Disa prej tyre kanë filluar të shkatërrohen. Këtu përmenden Berzanaj, Baban 1 dhe Funar 2/2.
 - **Si konkluzion mund të themi se kapaciteti ujëmbledhës i rezervuarëve është ulur me 30% ose me rreth 40,000 Ha.**

Mirëmbajtja, mbikqyrja dhe inspektimi

- Eshtë vënë re një mungesë e mirëmbajtjes, mbikqyrjes dhe programi inspektimi, dhe në një numër të madh rastesh digat nuk inspektohen ose rekomandimet e dhëna nga inspektimet nuk janë marrë parasysh. Shumica e digave nuk kanë instrumenta monitorimi, pjezometra, reperat e nivelematës, gjë që duhet të korrigojë, sepse egzistenca e tyre do të bënte të mundur që problemet të identifikohen në kohë, para se diga të shkatërrohet, e së fundmi të ndërhyhet në kohë.
- Rëndësia e rrugëve të shërbimit nuk duhet kursesi të nënvlerësohet. Me rrugë të rregullta shërbimi, digat mund të vizitohen, inspektohen e mirëmbahen më lehtë, e mbi të gjitha në një rast emergjence, stafi, materialet dhe pajisjet mund të shkojnë në digë.



Funksionimi i rezervuarëve dhe modernizimi i tyre

- Në një shumicë digash funksionimi i rezervuarëve është në shkallë shumë të ulët. 29 diga kanë pellg ujëmbledhes shumë të vogël dhe kanal ushqyes jashtë funksioni, ose pa sipërfaqe ujitëse poshtë tyre, ose me rrjet ujitës jashtë funksioni. Këto diga paraqesin një rrezik, ndërkohë që asnjë përfitim nuk merret nga to.
- Një numër i madh digash janë gjetur të pyllëzuara. Një pastrim kohe pas kohe i rregullt i bimesise mbi diga është një rekomandim i dhënë pothuaj për të gjitha digat.
- Ka një numër të madh problemesh serioze me digat dhe tërësinë e Inspektimit, Mirëmbajtjes dhe regjimin e monitorimit. Modernizimi i digave kërkohet të bëhet urgjentisht dhe tërësia e inspektim-mirëmbajtje-monitorim duhet të organizohet që ky investim kapital të bëhet efektiv.




Kosto për riparimin e digave dhe rritjen e sigurisë së digave

- Vlera e përafërt për 195 diga vlerësohet 60 milion USD. Këtu nuk përfshihen punimet për heqjen e sedimenteve nga rezervuarët të cilat do të kishin jo vetëm një kosto të jashtëzakonshme financiare (qindra milion dollarë) por edhe impakte mjedisore në vendet e shkarkimit.
- Në kuadrin e Projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes të financuar nga Banka Botërore gjatë vitit 2015 është ndërhyrë në 11 diga më një vlerë totale investimi rreth 9 milion USD.
- Disa nga digat ku janë kryer investimet janë: Thana, Kurjan Strume, Duhanas, Belosovë, Zharrëz, Koshnicë etj.



- **Rekomandime**

- Pranë cdo Bordi Kullimi/Njësie të Qeverisjes Vendore duhet të krijohet një njësi brenda stafit të tyre të dedikuar për funksionimin, mirëmbajtjen dhe monitorimin e digave që gjenden në territorin e tyre dhe administrohen nga ata.
- Cdo digë duhet të ketë dosjen e saj në përputhje me Udhëzimin Nr.4 datë 18.07.2003
- Eshtë nevoja që të ngrihet po ashtu një njësi qendrore e cila të mbështesë e asistojë njësitë respektive të Bordeve të Kullimit dhe Bashkive .
- Inspektimet periodike të digave janë të ligjëruara për t'u bërë një herë në vit nga pronari apo përdoruesi dhe një herë në 10 vjet nga inxhinieret e Komitetit Kombetar të Digave të Mëdha (KKDM). Ky system nuk ka funksionuar si duhet.
- Inspektimet periodike duhen bërë nga inxhinierë profesionistë të përcaktuar nga pronari dhe të miratuar nga KKDM.

- 
- Hartimi i Planeve të Emergjences. Një formular standard i Planit të Emergjencës (PE) është hartuar si pjesë e projektit të Bankës Botërore.
 - Hartimi i një database e Digave (GIS Database). Kjo lejon që me pak mundim të gjitha digat të përcaktohen si vendndodhje dhe njihjen me të dhenat e mbledhura (prodhuara) nga ky projekt dhe të atyre që mund të mblidhen (prodhohen) në të ardhmen. Në këtë strukturë (software) të renditen edhe direktori të tjera që përmbajnë për çdo digë, foto, raportin e inspektimit me të fundit, vizatime (elektronike), planet e emergjencës etj. Bazuar në moshën dhe experiencën e disa eksperteve të digave në Shqipëri, mbledhja e njohurive duhet të bëhet një prioritet. Këto njohuri duhen përfshirë në database.
 - Kryerja e studimit edhe për pjesën tjetër të digave të papërfshira në këtë studim, pra të rreth 400 digave të tjera.
 - Nevoja për gjetjen e burimeve të reja për ujitje duke patur parasysh se digat e kanë kaluar periudhën e tyre të jetëgjatësisë së projektuar.

Diga me probleme



Diga Izvor. Carje në shpatullën e djathtë

Diga me probleme



Diga Vranisht. Rrëshqitje në bjefin e poshtëm

Diga me probleme



Diga Koshnicë. Rrëshqitje në bjefin e poshtëm

Diga me probleme



Diga e Thanës. Shkarje në bjefin e sipërm

Diga me probleme



Diga e Shardushkut. Ulje kurore sufozi.

Punime Riparimi në Diga



Diga Thanë. Punime për riparimin e shkarjes, kontrabankinë dhe drenazhim

Punime Riparimi në Diga



Diga Koshnicë. Punime për riparimin e shkarjes

Punime Riparimi në Diga




Diga Kurjan. Punime sistemi dhe drenazhimi në digë

Punime Riparimi në Diga



Diga Vranisht. Punime për rehabilitimin e digës



JU

FALEMINDERIT